



## **Ghadir Khumm**

© dielli.net



*“O ti i dërguar!Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën në tërësi komunikimin, atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve”. Maide, 67*

*“Sot e përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe” Maide, 3*

Falënderimi qoftë për Allahun, zotëruesin e botëve, I cili gjendet në mirësi e bujari ndaj neve duke na udhëzuar në rrugën e drejtë dhe I cili dhuron çdo të mbarë dhe lumturi me qëllim që robërit e Tij të bëhen prej të sinqertëve. Çdo kush që i mbështetet Atij, do t’i mjaftojë vetëm Ai dhe Ai do ta mbrojë atë prej shejtanëve. Çdo kush që e kthen fytyrën prej rrugës së Tij, do të poshtërohet dhe do të përbuzet.

Përsëndetja dhe mëshira qoftë mbi të Dërguarin e Tij, që është dërguar si mëshirë për botët, si ndihmës i atyre që mbështeten dhe prijës i besimtarëve.

Përsëndetja dhe mëshira qofshin edhe mbi Ehli Bejtin e pastër dhe të dëlirë, që janë pishtarët e udhëzimit dhe që janë quajtur si anija shpëtuese, pozitat e të cilëve janë më të larta prej të gjithë njerëzve.


I lutem Allahut ta udhëzojë Ummetin e Muhamedit. Derisa të bëhet Ummeti më i mbarë dhe derisa të gjithë njerëzit të tubohen nën flamurin e udhëzimit të Hz Mehdiut (a.f.). “Edhe nëse nuk e pëlqejnë jobesimtarët, Allahu do ta plotësojë dritën e Tij”.

### **“Ti je vetëm ai që e tërheq vërejtjen, çdo popull e ka udhëzuesin” (Rad, 7)**

Çdo vit, me arritjen e datës 18 Dhul Hixhxeh, në shpirtin dhe zemrat e myslimanëve ngjallet kujtimi i një ngjarjeje të pavdekshme, ngjarje e cila ndodhi mbas Haxhit Lamtumirës të Hz Resulullahut (s.a.a.) në një vend të quajtur Gadir Hum. Gadiri ishte një kënetë, në rrugën në mes Mekes dhe Medines, ku karvanët e udhëtareve ndaleshin për të pushuar. Por, atë ditë pranë kësaj kënete, ndodhi ajo ngjarje e madhe.

Ishte orët a para të ditës së enjte dhe Hz Resulullahu (s.a.a.) ishte duke u kthyer nga Haxhi i tij i fundit. Në çdo anë dëgjohej zëri i udhëtareve të karvanit dhe hingëllima e kuajve dhe deveve. Por, në mes të kësaj zhurme, fytyra e ndritur e Hz Resulullahut (s.a.a.) tregonte se ai ishte thelluar në mendime dhe sikur ishte në pritje të një ngjarjeje të madhe. Kur karvani arriti në Gadir Hum, vendi ku irakianët, egjiptianet dhe popujt tjerë duhej të ndaheshin nga njëri-tjetri, Hz Resulullahu (s.a.a.) ndjeu prezencën e ngrohtë të Xhibilit (a.s.), engjëllit të shpalljes, i cili erdhi me një mesazh të ndritur nga ana e Allahut, dhe iu drejtua Hz Resulullahut (s.a.a.) duke i thënë:

O Muhammed, Allahu të dërgon selamin dhe të shpall këtë:



***“O ti i dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën në tërësi komunikimin, atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve”. (Maide, 67)***

Shumë dijetar të Ehli Sunnetit kanë pranuar se ky ajet është shpallur në Gadir Hum me rastin e emërimit të Hz Aliut (a.s.) si kalif, dhe në lidhje me këtë çështje kanë transmetuar hadithe, vërtetësia e të cilëve është vërtetuar sipas kriterëve të saktësisë së hadithit. Ja disa burime të Ehli Sunnetit që kanë të bëjnë me këtë çështje:

- 1-Hafëz Ebu Naimi në librin “Nuzul-ul Kitab”
- 2-Imam Vahidi në librin “Esbab-un Nuzul”, faqe 150
- 3-Imam Ebu Is-hak Sa’lebi në tefsirin “El Kebir”
- 4-Hakim Haskani në librin “Shevahid-ut Tenzil li kawai-it tefzil”, v.1, f.187
- 5-Xhelaledin Sujuti, në tefsirin “Durr-ul Mensur”, v.3, f.117
- 6-Fahru Razi në tefsirin “El Kebir”, v.12, f. 50
- 7-Muhammed Rashid Riza, në tefsirin “El Menar”, v.2, f.86
- 8-Ibni Asakir në librin “Tarihi Dimeshk”, v.2, f.86
- 9-Shevkanî në librin “Feth-ul kadir”, v.2, f60
- 10-Ibni Talha Shafi në librin “Metalib-ul Seul”, v.1, f.44
- 11-Ibni Sabbag Maliki në librin “Fusul-ul Muhimme”, f,25
- 12-Kunduzi Hanefi në librin “Jenabi-ul Mevedde”, f,120
- 13-Shehristani në librin “El Milelu Ven Nihel”, v.1, f.163
- 14-Ibni Xherir Taberi në “Kitab-ul Vilajet”
- 15-Ibni Said Sexhistani në “Kitab-ul Vilajet”
- 16-Bedruddin Hanefiu në “Umdet-ul Kari fi sherh-il Buhari”, v.8, f.584
- 17-Abdul Vahhab Buhari në “Tefsir-ul Kuran”
- 18-Alusi në “Ruh-ul Meanî”, v.2, f.384
- 19-Hamvini në librin “Faraid’us Simtejn”, v.1, f.185
- 20-Allame Sejjis Siddik Hasan Hani në “Fet-hul Bejan fi Mekasid-il Kuran”, v.3, f.63


Ajeti i lartpërmendur na tregon në mënyrë të qartë se misioni i të Dërguarit (s.a.a.) është duke përfunduar, por te populli duhet të arrijë një e vërtetë. Kjo e vërtetë është aq e rëndësishme, sa që nuk është e mundur përkryerja e fesë pa të. Hz Resulullahu (s.a.a.), i cili ndiente një barë të rëndë mbi supe, u bë gati që njerëzve t’i parashtrij një çështje të rëndësishme. Pastaj, tha që të kthehen ata të cilët kanë ecur përpara dhe ata te cilët kanë mbetur mbrapa karvanit, dhe t’i bashkohen turmës së njerëzve para tij. Pas disa minutave të gjithë u mblodhën rreth kënetës Gadir Hum dhe me padurim prisnin që të kuptonin se pse Hz Resulullahu (s.a.a.) i ka ndalur të gjithë këta njerëz në këtë shkretëtirë? Menjëherë nga samarët e deveve ndërtuan një mimber (foltore) për Hz Resulullahun (s.a.a.), i cili u ngjit mbi të dhe duke u drejtuar përafërsisht njëqind mijë sahabeve të pasionuar tha:

“Ndoshta, pas këtij viti nuk do t’ju shoh më përsëri. Është afër koha e dërgimit të ftesës nga ana e të dërguarit të Allahut dhe të pranimit të saj nga ana ime.”

Hz Resulullahu (s.a.a.) e thirri Hz Aliun (a.s.) që të shkojë pranë tij. Më pas ia ngriti dorën dhe tha:

“Ai që më pranon si udhëheqës (mevla), edhe Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah, duaje atë, i cili e do Aliun. Kush bëhet armiku i Aliut, Ti bëhu armiku i tij. Ndhimjoje atë i cili e ndihmon Aliun. Braktise atë që e braktis Aliun dhe kudo që të shkojë, le të jetë e vërteta me të”

Pastaj, e hoqi kapelën prej kokës së tij dhe e vendosi në kokën e Hz Aliut (a.s.) dhe i përgatiti një vend (çadër) të veçantë. Pastaj, dha urdhër që të vijnë sahabet në grupe dhe të mëdhenjtë e Kurejshëve dhe Ensarëve për ta përshëndetur Hz Aliun (a.s.) me titullin “Emirel Muminun” (Udhëheqësi i besimtarëve). Dhe, të gjithë sahabet duke filluar prej Ebu Bekrit dhe Ymerit, ia uruan të gjithë. Madje, Ebu Bekri dhe Ymeri i thanë: “Të lumtë o djali i Ebu Talibit që u bërë udhëheqësi i ynë dhe i të gjithë besimtarëve”. Mbas që përfundoi ceremonia e urimit, Hz Resulullahu (s.a.a.) tha se u shpall ajeti:



***“Sot e përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju Islamin fe” (Maide, 3)***

Mbas emërimit të Hz Aliut (a.s.) si Imam dhe mbas shpalljes së ajetit për përkryerjen e fesë, Hz Resulullahu (s.a.a.) deklaroi:

“Falënderimi qoftë për Allahun që e përsosi fenë, plotësoi dhuntinë dhe mbas misionit tim tregoi kënaqësi për caktimin e Ali ibni Ebu Talibit si Imam.”

Sipas disa haditheve, Hz Resulullahu (s.a.a.) e bëri komunikimin në këtë mënyrë:

“Më erdhi Xhebraili nga ana e Allahut dhe më urdhëroi që të gjithë të bardhave dhe të zezave t’i bëjë shpalljen e Ali ibni Ebu Talibit si vëlla e trashëgimtar timin dhe si kalif dhe Imam mbas meje. Unë kërkova nga Xhebraili që Allahu të më kursejë nga kjo shpallje, sepse të paktë janë të devotshmit ndërsa të shumtë janë ata që do të më mendojnë dhe urrejnë për shkak të marrëdhënies sime familjare me Aliun. Nëse doni, mund të tregojë edhe emrat e tyre, por e rruaj fisnikërinë time duke e mbajtur të fshehtë emrat e tyre. Por, Allahu nuk pranoi që unë të përmbahem prej komunikimit. O ju njerëz, dijeni që Allahu ka zgjedhur Aliun për juve si udhëheqës dhe Imam, dhe e ka bërë obligim për çdo person bindjen ndaj tij.”

Allahu në Gadir Hum i caktoi Imamët (a.s.) e pastër nga mëkatet si trashëgimtar të Hz Muhammedit (s.a.a.) dhe si udhëheqës të myslimanëve, të cilëve ua dha diturinë e librit dhe urtësinë. Dhe, në këtë rast edhe myslimanët e tjerë duhet të pranojnë dhe t’i dorëzohen zgjedhjes dhe urdhrin të Allahut. Sepse, edhe në kuptimin e përgjithshëm, Islami do të thotë dorëzimi ndaj Allahut. Allahu, në ajetin e 68-të, 69-të dhe 70-të të sures Kasas thotë:

(وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ مَا كَانَ لَهُمُ الْخَيْرَةُ لَئِنْ لَمْ يَنْزِلْ بِآيَاتِنَا وَسَخَّرْنَا لِحَكْمِكَ الْفُلَ الْمَجْهُولَ لَتَكُنَّ مِنَ الْخٰسِرِيْنَ  
عَمَّا يُشْرِكُوْنَ وَرَبُّكَ يَعْلَمُ مَا تُكِنُّ صُدُوْرُهُمْ وَمَا يَغْلِبُوْنَ وَهُوَ اللّٰهُ لَا إِلٰهَ إِلَّا هُوَ لَهُ الْحَمْدُ فِي الْاٰوَّلٰى وَالْاٰخِرَةِ وَلَهُ الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُوْنَ).

***“Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë, atyre nuk u takon zgjedhja. I pastër dhe i lartë është Allahu nga çka i përshkruajnë për shok. Dhe Zoti yt e di se ç'fshehin zemrat e tyre dhe se ç'shfaqin haptazi. Ai është Allahu, nuk ka zot tjetër pos Tij, vetëm Atij i takon falënderimi në këtë botë dhe në botën tjetër dhe vetëm Atij i takon gjykimi dhe te Ai ktheheni”***

Ngjarja e Gadirit mund të shqyrtohet dhe të diskutohet në disa aspekte. Njëri prej këtyre aspekteve është vizioni i Hz Resulullahut (s.a.a.) mbi të ardhmen e Islamit. Padyshim, themeluesi i çdo feje është i shqetësuar për fatin dhe vazhdimin e asaj që ka predikuar. Sigurisht që edhe profeti Muhamed (s.a.a), nuk do të kishte lënë të ardhmen e myslimaneve dhe të fesë së Allahut pa ndonjë program të caktuar. Në ditën e Gadirit, Hz Resulullahu (s.a.a.) me urdhrin e Allahut ua sqaroi fatin e udhëheqjes së shoqërisë Islame pas largimit të tij dhe në këtë mënyre e plotësoi fenë Islame. Zgjedhja e Hz Aliut (a.s.), në të vërtetë ishte vazhdimi i programeve dhe politikave të Hz Resulullahut (s.a.a.), të cilat duhej që të kryheshin nga njerëzit më të mirë dhe më të ditur.

Gadiri mund të analizohet edhe nga një aspekt tjetër: arsye e zgjedhjes së një personaliteti të tillë si Hz Aliu (a.s.) për udhëheqës. Shkaku i zgjedhjes së Hz Aliut (a.s.) në ditën e Gadirit kishte të bëjë me virtytet dhe vlerat e larta të cilat ishin zhvilluar në personalitetin dhe shpirtin e tij. Për këtë arsye, vullneti hyjnor u realizua në atë mënyrë që Hz Aliu (a.s.), i cili posedonte këto veçori, të emërohej si zëvendësi më i përshtatshëm i Hz Resulullahut (s.a.a.).

Gadiri nuk ishte vendi dhe rasti i parë që Hz Resulullahu (s.a.a.) e miratonte Hz Aliun (a.s.). Ai, që nga fillimi i profetësisë së tij, Hz Aliun (a.s.) e cilësonte si të ndryshëm nga të tjerët për shkak të tipareve që i zotëronte. Sahabet disa herë kishin dëgjuar këtë fjali nga goja e Hz Resulullahut (s.a.a.): ”Unë jam nga Aliu dhe Aliu është nga unë”. Në ditën e Gadirit, në mesin e myslimanëve vëreheshin shumë fytyra dhe personalitete të dalluara, por Hz Resulullahu (s.a.a.) me vullnetin e Allahut, për këtë çështje të rëndësishme e zgjodhi më të mirin prej tyre, sepse shoqëria njerëzore ka nevojë për lider të zgjuar, përhapës të drejtësisë, besimtar dhe trim. Devotshmëria, drejtësia, dituria dhe humanizmi i Hz Aliut (a.s.) janë ornamente të faqeve të historisë dhe Hz Resulullahu (s.a.a.) më shumë se çdo kush tjetër ishte në dijeni për këtë. Hz Aliu (as), gjatë jetës së tij dhe në veçanti në periudhën e kufizuar të udhëheqjes mbi myslimanet, asnjëherë nuk ka menduar për interesa personale dhe asnjëherë nuk e devijuan atë ofertat dhe kërcënimet. Hz Aliu (as), gjithë jetën e tij të begatshme e kaloi në rrugën e vërtetë dhe në drejtësi. Dhe, I dërguari i Zotit me zgjedhjen e tij, u tregoi myslimaneve se fati dhe udhëheqja e tyre duhet të lihet në dorë të njerëzve të sinqertë dhe se çdo kush nuk e meriton këtë përgjegjësi. Në këtë mënyrë, ngjarja e Gadirit është dëshmuar e një të vërtete: se udhëheqësi dhe drejtuesi (mevla) i njerëzve mund të bëhet ai person i cili e pranon qeverisjen për hir të vendosjes së drejtësisë dhe lumturisë së shoqërisë, e jo për hir të dëshirës për pushtet dhe egoizëm. Një personalitet i këtillë duhet të jetë i drejte, i devotshëm, mendimtar dhe dijetar në mënyrë që shoqërinë njerëzore ta ngritë në kalanë e drejtësisë dhe të sigurisë.

Ditët e festave në kulturën Islame janë ditë të respektit dhe pyetjes së halleve të të tjerëve. Gjithashtu, ato janë ditë të largimit të pikëllimit nga zemrat e thyera dhe ditë të vizitave dhe shikimeve të dashura ndërmjet njerëzve. Është e porositur që në ditën e Gadir Humit myslimanet t'i gëzojnë zemrat e besimtareve dhe t'u ndihmojnë të dobëtëve. Edhe vetë Hz Aliu (a.s.), në një vend thotë: “Mëshira reciproke në ditën e festës së Gadirit tërheq shikimin e butë dhe të dashur të Zotit.”

Falënderuar qoftë Allahu, I cili na udhëzoi dhe na bëri që ta përqafojmë dhe festojmë festën e Gadir Humit

### **Argumentet që e vërtetojnë vilajetin e Hz Aliut (a.s.)**

Allahu i ka sprovuar myslimanët me pranimin e vilajetit të Hz Aliut (a.s.) dhe është duke i sprovuar ende. Zaten edhe kundërshtimet në mes të mez-hebeve për burim të tyre e kanë kryesisht këtë sprovë. Por, për hir të mëshirës së Tij të pafundme ndaj robërve, Allahu nuk do t'i dënojë ata të mëvonshmit për shkak të të bërave të mëhershmeve. Dhe, për hir të të urtësisë së Tij të madhe, caktimin e Hz Aliut (a.s.) për kalif e ka ngurtësuar përmes disa ngjarjeve të rëndësishme dhe shenjave të qarta që i përngjajnë çudirave dhe e ka penguar harresën e saj. Dëshmitarët që ishin prezent gjatë këtyre ngjarjeve, ishin të detyruar t'i tregojnë të tjerëve dhe kështu është hapur rruga e zbulimit të së vërtetës për hulumtuesit dhe kërkuesit e mëvonshëm.

**Argumenti i parë:** Ka të bëjë me dënimin e mohimit të Imametit dhe të vilajetit të Hz Aliut (a.s.). Kjo ka të bëjë me ngjarjen e periudhës mbas Gadir Humit, kur u caktua Hz Aliu (a.s.) për kalif i myslimanëve dhe kjo u bë obligim për të pranishmit që t'u përcjellin atyre që nuk ishin prezent në atë tubim. Ky është rrëfimi për incidentin:

Kur e dëgjoi lajmin e emërimit për kalif të Hz Aliut (a.s.), Haris ibni Numan Fihriu nuk mundi ta durojë këtë dhe u drejtua kah Mesxhidi i Hz Resulullahut (s.a.a.). E lidhi devenë përpara Mesxhidit hyri brenda, u ngul në një vend përpara Hz Resulullahut (s.a.a.) dhe pa i dhënë selam i tha: “O Muhamed, ti na urdhërove që të besojmë në njësinë e Allahut dhe se ti je i dërguari i Tij; në këtë e dëshmuam dhe e pranuan. Na urdhërove që të falemi pesë herë në ditë, agjërimin e muajit Ramazan, shkuarjen në Bejtulla për haxh dhe dhënien e zeqatat prej mallit, dhe ne i pranuan edhe këto rregulla. Pastaj, nuk u mjaftove me kaq dhe duke ia ngritur dorën djalit të axhës e shpalle atë si më të virtytshmin prej të gjithë njerëzve dhe ke thënë ‘Udhëheqësi i kujt jam unë, edhe Aliu është udhëheqësi i tij’. A është ky vendimi yt apo është ndonjë urdhër i Allahut?”

Kur i dëgjoi këto fjalë Hz Resulullahu (s.a.a.), iu skuqën sytë prej shqetësimit dhe në këtë gjendje i tha: “Betohen në Allahun që është Një, kjo nuk është prej meje por prej Allahut”. Dhe, këtë e përsëriti tri herë.

Atëherë Harisi tha: “O Allah, nëse është e vërtetë thënia e Muahmmedit, më dërgo një gur nga qielli ose ndonjë dhimbje tjetër” dhe pastaj u ngrit dhe u largua nga ai vend.”

Rrëfyesi na tregon më tutje:

“Betohem në Allahun se pa mbërritur Harisi deri te deveja e tij, nga qielli rra një gur dhe e qëlloi për kokë, ku edhe vdes në vend. Atëherë Allahu e shpalli këtë ajet:

(سَأَلْنَا نُنزِّلُ الْعَذَابَ وَأَقْبَلْنَا لِلْكَافِرِينَ لَيْسَ لَهُ دَافِعٌ)  
TAYIN EDHIMESI HARBINI DAVUNCA DUA  
GIMNIN

**“Një lutës e kërkoi dënimin e pashmangshëm për jobesimtarët. Atë (dënim) s'ka kush që mund ta ndalë.” (Mearixh, 1-2)**

Këtë ngjarje e kanë transmetuar edhe shumë dijetar të Ehli Sunnetit.

**Argumenti i dytë:** Ka të bëjë me fitimin e dënimin për shkak të mallkimit të Hz Aliut (a.s.) drejtuar atyre sahabeve që i shmangeshin dëshmimit për ngjarjen e Gadir Humit.

Në kohën kur ishte kalif Hz Aliu (a.s.), duke mbajtur një fjalim përpara popullit në njërin prej ditëve të rëndësishme, Hz Aliu (a.s.) u tha: “Le të qohen në këmbë ata mysliman që kanë qenë dëshmitar të Ditës së Gadir Humit dhe që e kanë dëgjuar Hz Resulullahun (s.a.a.) duke thënë: ‘Udhëheqësi i kujt jam unë, edhe Aliu është udhëheqësi i tij’. Të mos qohen ata që nuk e kanë parë me sytë e tyre dhe që nuk kanë dëgjuar me veshët e tyre”

Atëherë u ngritën tridhjetë sahabë, gjashtëmbëdhjetë prej të cilëve ishin pjesëmarrës së luftës së Bedrit, dhe e vërtetuan thënien e Hz Resulullahut (s.a.a.): ‘Athua e dini se unë jam më i epërmi i juaj sesa ju vetë?’, dhe që pas pohimit Hz Resulullahu (s.a.a.) u kishte thënë ‘Udhëheqësi i kujt jam unë, edhe Aliu është udhëheqësi i tij’.

Por, për shkak të armiqësisë dhe xhelozisë që e ushqenin ndaj Hz Aliut (a.s.), disa sahabë nuk u quan në këmbë për të dëshmuar. Njëri prej tyre ishte Enes ibni Maliki, që mbasi që zbriti prej foltores, e pyeti: ‘O Enes, pse nuk dëshmove edhe ti bashkë me ata?’, ndërsa ky iu përgjigj: ‘O Udhëheqësi i Besimtarëve, tash më jam plakur dhe kam harruar çka kam dëgjuar’. Atëherë, Hz Aliu (a.s.) e mallkoi: ‘Nëse gënjen, le të dënojë ty Allahu me një sëmundje që nuk do ta mund ta fshehësh atë me mbulesën tënde’

Mbas kësaj, Enes ibn Maliki u sëmur nga leproza ende pa luajtur nga vendi. Pastaj, Enesi duke vajtua thoshte: “Më zuri mallkimi i robit të singertë, sepse e fsheha dëshminë e tij”


Ky është një rrëfim i mrekullueshëm. Në librin e tij “El Mearif”, Ibni Kutejbe duke i numëruar emrat e personave të njohur që janë sëmurë nga sëmundjet e ndryshme, te sëmundja e leprozës e përmend edhe emrin e Enesit dhe e transmeton edhe këtë rrëfim. Këtë ngjarje e transmeton edhe Ahmed ibn Hanbeli në Musnedin e tij dhe ka thënë se: “Përveç tre personave, të gjithë kanë dëshmuar, dhe të tretë janë zënë nga mallkimi i Imam Aliut (a.s.)”

Këtu do të jetë mirë t’i përmendim emrat e atyre tre personave, të cilët i ka përcjellë El Belazurit Ahmed ibn Hanbeli. Ai thotë: “Kur kërkoi Hz Aliu (a.s.) që të dëshmojnë për Ditën e Gadir Humit, nën foltore ishin të ulur Enes ibni Maliki, Bura ibni Azibi dhe Xherir ibni Abdullah Bexheli. Përkundër përsëritjes së kërkesës së Hz Aliut (a.s.) për t’u quar në këmbë dëshmitarët, këta të tretë nuk lëvizën nga vendi. Atëherë, Hz Aliu (a.s.) tha: “Qoftë fatkeqësia e Allahut mbi ata persona që e fshehin këtë dëshmi; ajo fatkeqësi qoftë e tillë ashtu që të njihet përmes saj dhe e mbërihtë atë para se të vdesë.

Rrëfuesi tregon se Enes ibn Maliku u sëmurë nga leproza, Bura ibni Azibi u verbërua dhe Xherir ibni Abdullahu u kthye përsëri në jetën e tij nomade dhe vdiq te shtëpia e nënës së tij në Sherat.

### **Ajetet e Kuranit që kanë të bëjnë me personalitetin e Hz Aliut (a.s.)**

Në ajetin e 55-të dhe 56-të të sures *Maide* shkruan:



*“Miku (i afërmi) juaj i vërtetë është vetëm Allahu, i dërguari i Tij dhe ata që besuan, që e falin namazin dhe japin zeqatin duke bërë ruku. E kush e ka për mik Allahun, të dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s’ka dyshim se ana (pala) e Allahut është ngadhënjyese”*

Në komentin e Kuranit “El-Kebir” të Imam Ebi Is-hak Salebiut është transmetuar një hadith i Ebu Zer Gaffarit, ku vetë Ebu Zerri rrëfen:

*“Unë kam dëgjuar vetë me këta dy vesh, përndryshe qofshin të shurdhër të dytë, dhe kam parë me këta dy sy, përndryshe qofshin të verbër të dytë, se Resulullahu ka thënë:*

*“Aliu është udhëheqësi i besimtarëve dhe mbytësi i idhujtarëve; kush i ndihmon Aliun, do ta ndihmojë Allahu atë; kush që e braktis Aliun, do ta braktis Allahu atë”*

*Dijeni se një ditë unë isha duke u falur bashkë me Resulullahun dhe në mesxhid erdhi një lypës për të kërkuar ndihmë prej popullit. Por, askush nuk i dha asgjë. Hz Aliu ishte në pozitën e rukusë dhe ia zgjati gishtin e unazës; në atë gisht kishte një unazë. Fukarai erdhi dhe e nxori atë unazë prej gishtit. Atëherë Resulullahu iu lut Allahut në këtë mënyrë:*

*“O Allah, vëllai im Musa duke Të bërë lutje thoshte: O Zoti im. Më zgjero gjoksin tim, dhe më lehtëso në këtë punë timen. Më zgjidh nyjën e gjuhës sime që të kuptojnë fjalën time. Më cakto një ndihmëtar nga familja ime; Harunin, vëllain tim. Që të ma forcosh fuqinë time. Bëma shok atë në punën time, në mënyrë që të madhërojmë Ty më tepër. Dhe të përkujtojmë Ty shpesh. Vërtet, ti je Ai që sheh dha na i di punët”. Dhe Ti iu përgjigje:*

*“O Musa, u pranua lutja jote dhe t’u dha ajo që kërkoje”*

*O Allah, edhe unë jam robi dhe i dërguari Yt. Zgjeroje edhe gjoksin tim, më lehtëso punën time. Më cakto nga familja ime Aliun si ndihmëtar dhe më forco me atë.*

*Ebu Zerri thotë kështu: Beto hem në Allahun, ende nuk kishte përfunduar fjalën Resulullahu, kur Gjibrili erdhi dhe e shpalli këtë ajet:*

*“Miku (i afërmi) juaj i vërtetë është vetëm Allahu, i dërguari i Tij dhe ata që besuan, që e falin namazin dhe japin zeqatin duke bërë ruku. E kush e ka për mik Allahun, të dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s’ka dyshim se ana (pala) e Allahut është ngadhënjyese”*

Disa tefsire tjera të Ehli Sunnetit, ku është regjistruar hadithi i lartëpërmendur:

1-“El Keshshaf” i Zemhasherit, v.1, f.649

2-Tefsiri Taberi, v.6, f.649

3-“Zad-ul Mesir fi Ilm-it Tefsir” i Ibni Xhevizit, v.2. f.383

4-Tefsiri Kurtubi, v.6, f.219

5-Tefsiri Fahu Razi, v.12, f.26

6-Tefsiri Ibni Kethir, v.2, f.17



- 7-Tefsiri Nesfi, v.1, f.289
- 8-“Shevahi-ut Tenzil” i Hesevani Hanefiut, v.1, f.161
- 9-“Durr-ul Mensur” i Sujutit, v.2, f.293
- 10-“Esbab-un Nuzul” i Imam Vahidit, f.148
- 11-“Ahkam-ul Kur’an”, v.4, f.102
- 12-“Et-Tes-hil li ulum’it Tenzil” i Xhessasit, v.1, f.181

### **Disa nga hadithet e Hz Resulullahu (s.a.a.) në lidhje me Hz Aliun (a.s.):**

“Dashuria ndaj Aliut është prej imanit, ndërsa armiqësia ndaj tij është prej dëshirës së përçarjes”.

“Aliu është prej meje dhe unë jam prej Aliut”

“Çdo kush që dëshiron të jetojë si unë, të vdes si unë dhe të fitojë Xhenetin e Huld-it të cilin e kam fituar unë, le ta pranojë udhëheqjen e Ali ibn Ebi Talibit. Ai nuk do t’ju nxjerrë nga rruga e drejtë asnjëherë dhe nuk do të devijoni asnjëherë”

“Aliu është dera e diturisë sime”

“Dijeni që, çdokush që vdes me dashurinë ndaj Al-i Muhamedit (Familjes së Muhamedit), ka vdekur me vdekjen e martirit; dijeni që, çdokush që vdes me dashurinë ndaj Al-i Muhamedit, është i falur nga Allahu; dijeni që, çdokush që vdes me dashurinë ndaj Al-i Muhamedit, është i pranuar pendimi i tij; dijeni që, çdokush që vdes me dashurinë ndaj Al-i Muhamedit, ka vdekur si një besimtar me imanin e përkryer; dijeni që, çdokush që vdes me dashurinë ndaj Al-i Muhamedit, engjëlli i vdekjes do ta përgëzojë me xhenet”

\*\*\*\*\*

*“Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij caktojnë diçka, atëherë as besimtari as besimtarja nuk kanë të drejtë të sillen sipas mënyrës së vet. Dhe kush nuk e dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e tij, ai me siguri ka humbur keq” (Ahzab, 36)*

*“O besimtarë, përuluni Allahut dhe nderoni Profetin, por edhe përfaqësuesit tuaj. Por nëse nuk pajtoheni në ndonjë çështje, drejtoheni Allahut dhe Profetit, nëse i besoni Allahut dhe botës tjetër; ajo është më e mirë dhe më e bukuri shpjegim” (Nisa, 59)*

*“Atëherë kur Zoti e provoi Ibrahimin me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai tha ‘Unë po të bëj ty imam të njerëzimit’. Ai tha ‘Bën o Zot edhe nga pasardhësit e mi!’. Zoti tha ‘Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët’”(Bekare, 124)*

*“Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur”(Sexhde, 24)*

*“Dhe ata i bëmë shëmbëlltyrë që e udhëzonin popullin sipas urdhrit tonë, i orientuam në punë të mira, në faljen e namazit, në dhënien e zeqatat dhe ata ishin adhures Tanë të singertë”(Enbija, 73)*

*“Dhe ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues”(Kasas, 5)*

*“Po a është pra i denjë për ta pasuar atë, i cili udhëzon kah e vërteta, apo ai i cili nuk udhëzon përveç nëse e drejton dikush. Ç’është me ju, si po gjykoni?!”(Junus, 35)*

*“Betohem me vendet e yjeve dhe nuk ka dyshim që kjo, sikur ta kishit ditur, është një betim i madh, nuk ka dyshim se ky është një Kuran i bukur dhe i ndershëm; në një Libër të fshehur; nuk mund ta prekë atë askush, përveç të pastërve” (Vakia, 75-79)*

*“Allahu dëshiron që, vetëm e vetëm prej juve, Ehli Bejtit, t’i pastrojë të gjitha papastërtitë dhe t’ju sjelli në një gjendje të pastrimit të vërtetë”(Ahzap, 33)*

*“Pastaj, Librin u kemi lënë amanet robërve të zgjedhur” (Fatir, 32)*

*“Nëse nuk dini, pyetni ata që dinë” (Nahl, 43)*

*“Mbahuni të gjithë për litarin e Allahut dhe mos u përçani.”(Ali Imran, 103)*

*“Prej nga, - i thanë, - të na bëhet ai sundues kur ne jemi më të denjë se ai për të sunduar? Atij nuk i është dhënë as ndonjë pasuri e madh”. “Allahu atë e ka zgjedhur t’iu bëhet sundues”, - tha ai, - dhe e pajisi me dijeni dhe trup të zhvilluar”. – Allahu ia jep pushtetin kujt të dojë Ai. Allahu është i gjithëdijshëm”(Bekare, 247)*

*“Dhe mos u përçani në mes veti, pastaj do të dobësoheni dhe do ta humbni fuqinë”(Enfal, 46)*

*“E mos u bëni si ata që u ndanë grup-grupe edhe u përçanë në mes veti, pasi u patën zbritur argumentet”(Ali Imran, 105)*

*“A prej këtij ligjërimi (Kur'ani) po çuditeni? E po qeshni dhe nuk po qani?! Madje edhe e zëni në asgjë.” (Nexhm, 59-61)*

*“A mendojnë njerëzit se do të lejohen të thonë “ne besojmë” e të mos vihen në sprovë”(Ankebut, 2)*

*“Kurse shumica e njerëzve, edhe pse ti dëshiron, nuk janë besimtarë” (Jusuf, 103)*

*“Ne ju kemi sjellë të vërtetën, por shumicës nga ju e vërteta nuk i pëlqen” (Zuhruf, 78)*

*“Premtimi i Allahut është më se i vërtetë, por shumica e tyre nuk e dinë.” (Junus, 55)*

*“Allahu është dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk falënderojnë.” (Junus, 60)*